

VENDIM
Nr.958, datë 24.11.2010

**PËR MIRATIMIN E KONTRATËS ME NDARJE PRODHIMI PËR KËRKIMIN,
ZHVILLIMIN DHE PRODHIMIN E HIDROKARBUREVE NË SHQIPËRI, NË TOKË,
BLLOQET “4,5 DHE DUMRE”, NDËRMJET MINISTRISË SË EKONOMISË, TREGTISË
DHE ENERGJETIKËS TË SHQIPËRISË, PËRFAQËSUAR NGA AGJENCIA KOMBËTARE
E BURIMEVE NATYRORE (AKBN), DHE SKY PETROLEUM, INC**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5 e 13 të ligjit nr.7746, datë 28.7.1993 “Për hidrokarburet (kërkimi dhe prodhimi), të ndryshuar, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e kontratës me ndarje prodhimi për kërkimin, zhvillimin dhe prodhimin e hidrokarbureve në Shqipëri, në tokë, blloqet “4,5 dhe Dumre”, ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës të Shqipërisë, përfaqësuar nga Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore (AKBN), dhe Sky Petroleum, Inc., sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha